

URDHËR
Nr. 119, datë 15.6.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
POLICISË SË SHTETIT DHE DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIMIT ME KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE, NË KUADËR
TË PROJEKTIT TË INVESTIMIT “PËR ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E
PRONËS SHTETËRORE, NËNPROJEKTI ‘QENDRA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
PALASË’”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të vendimit nr. 321, datë 6.5.2026, “Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrative të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projekteve të investimit ‘Qendra e Shërbimeve Publike Palasë’, ‘Copëzat’”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Partnerit Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, z. Skënder Hita, dhe drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë, z. Simon Zereçi, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare, në kuadër të projektit të investimit “Qendra e Shërbimeve Publike Palasë”.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës së Shqipërisë, në inventarin e së cilës ndodhen pronat që transferohen sipas marrëveshjes, të ndjekë realizimin e procedurave për vënien në dispozicion dhe dorëzimin e pronave, sipas përcaktimeve të marrëveshjes dhe legjislacionit në fuqi.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e përfituesit kryesor nga projekti i investimit, të bashkëpunojnë me Korporatën e Investimeve Shqiptare dhe të ndjekin procedurat e tjera në zbatim të detyrimeve të parashikuara në marrëveshje, përfshirë përcaktimin e nevojave dhe specifikimeve teknike në lidhje me projektin.

4. Ngarkohen drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, z. Skënder Hita, dhe drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë, z. Simon Zereçi, për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Punëve të Brendshme për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari